



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

**Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada I Socijalne Zastite - Ministry of
Labor and Social Welfare**

PLANI I VEPRIMIT:
RRITJA E PUNËSIMIT TË TË RINJVE
2018-2020

17 dhjetor 2017

Shkurtesat

AAK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
APRK	Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DPP	Departamenti i Politikave të Punësimit, MPMS
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
MIN	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Industrisë dhe Tregtisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NEET	Të rinjtë as në punësim, as në arsim dhe as në trajnim
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
ZP	Zyret e Punësimit, APRK
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik/ Zyra e Kryeministrit

1. Hyrja dhe metodologjia

Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të Rinjëve është plan ndërsektorial trevjeçar që synon rritjen e punësimit dhe përmirësimin e punësueshmërisë për të rinjtë. Ky Plan është pjesë përbërëse e spektrit të dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës, të cilat si bosht orientues në nivel shtetëror e kanë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021. Duke e vendosur zhvillimin e kapitalit njerëzor si një prej katër shtyllave kryesore të strategjisë, filozofia zhvillimore e SKZH-së e trajton barazinë gjinore dhe përfshirjen shoqërore (ku përfshihen punësimi dhe arsimit) jo vetëm si rezultat por edhe si parakusht të zhvillimit. SKZH-ja ka përcaktuar disa prioritete dhe masa të përgjithshme se si ky synim mund të arrihet në fushën e punësimit, arsimit dhe aftësimin, si dhe ka përzgjedhur “prioritete të prioriteteve” në mes të gjithë sektorëve. Sidoqoftë, SKZH si dokument kornizë ju lejon hapësirë strategjive sektoriale që të ndërtojnë mbi filozofinë e saj dhe t’i përcaktojnë më hollësisht objektivat dhe masat konkrete të sektorëve, duke e lënë të hapur mundësinë e modifikimit të vetë prioriteteve të SKZH-së, i cili është dokument i gjallë dhe evolues.

Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të Rinjëve është zhvilluar me idenë se ky operon në kontekst të ndërveprimit me sektorë të tjerë të politikave publike dhe me strategjitë e tyre respektive. Në këtë drejtim, Plani i Veprimit para së gjithash është e informuar nga, dhe është në përputhje me, masat e parapara në Strategjinë Sektoriale të MPMS 2018-2022, Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (2017-2021), Strategjinë e Edukimit dhe Orientimit në Karrierë (2015-2019), dhe strategjitë e sektorëve tjerë që ndërlidhen me punësimin.

Plani i Veprimit është gjithashtu i udhëzuar nga zotimet politike të Kosovës të ndërlidhura me procesin e integritimit në Bashkimin Evropian (BE) dhe nismat rajonale. Si i tillë, Plani i Veprimit buron nga nevoja për t’i integruar në një dokument dhe për t’i bërë operacionale zotimet e Kosovës për reforma në fushën e punësimit, arsimit dhe aftësimin. Këtu përfshihen jo vetëm zotimet e përgjithshme në Strategjinë Kombëtare për Integrim Evropian (SKIE) 2020, por edhe masat e parapara në:

- *Planin e Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA) me BE-në (Vendimi Nr.05-V-246 i Kuvendit të Kosovës), më konkretisht masat e ndërlidhura me Kapitullin 19 të Acquis-së (“Politikat sociale dhe punësimin”).*
- *Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2016-2018 të miratuar nga Qeveria e Kosovës, më konkretisht me reformat strukturore nr. 17, 18, 19 dhe 20 që synojnë t’i përmirësojnë lidhjet në mes të sistemit të arsimit dhe të rrisin punësueshmërinë e fuqisë punëtore.*
- *Agjendën për Reforma Evropiane (ARE), që i përcakton prioritetet në dialogun mes Kosovës dhe BE-së, më konkretisht kapitullin e tretë mbi “Arsimin dhe Punësimin”.*
- *Strategjinë e Evropës Juglindore 2020 të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), që ka fokus të veçantë dhe objektiva të ndërlidhura me rritjen e punësimit.*
- *Vizioni i Kosovës për Shkathtësitë 2020 të Zyrës për Planifikim Strategjik.*
- *Udhërrëfytyrësi për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZh) 2016-2021*
- *Ligjin për Barazi Gjinore që garanton integritimin gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacionin dhe synon fuqizimin ekonomik dhe hapat për të përmirësuar pozitën e femrave apo meshkujve në fushën e punës, në arsim, në shëndetësi, kulturë dhe shpërndarjen dhe/ose rishpërndarjen e*

burimeve.

Në aspektin operacional, Plani i Veprimit ka për synim që të udhëzojë punën e institucioneve të Republikës së Kosovës në fushat e punësimit, arsimit dhe aftësimit, në periudhën 2018-2020, me qëllim të rritjes së punësimit të rinjve. Në nivel praktik ky plan do të shërbejë si bazë për të udhëzuar Planin Vjetor të Punës të Qeverisë në raport me politikat e punësimit dhe arsimit për të rinjtë, zhvillimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), buxhetin vjetor të Kosovës dhe strategjitë financuese të partnerëve zhvillimor.

Plani i Veprimit është punuar në përputhje me UA Nr. 02/2012 mbi strategjitë sektoriale dhe në koordinim me Zyrën për Planifikim Strategjik (ZPS) në Zyrën e Kryeministrit.

Plani i Veprimit për rritjen e punësimit të rinjve ka një kosto totale të zbatimit prej **17,440,104 EUR** për tri vite të zbatimit 2018-2020. Tabela 1 jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas fushave dhe viteve, ndërsa kjo bazohet në llogaritje të hollësishme të shpenzimeve për secilin aktivitet të planifikuar, ndërsa tabela 2 jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas fushave dhe burimeve të financimit.

Tabela 1. Përmbledhja e buxhetit sipas fushave dhe viteve

Fusha	Shpenzime gjithsej			
	2018	2019	2020	Gjithsej:
Punësimi	3,040,200 €	5,998,700 €	6,074,700 €	15,113,600 €
Arsimi dhe Aftësimi	805,668 €	982,268 €	538,568 €	2,326,504 €
Gjithsej:	3,845,868 €	6,980,968 €	6,613,268 €	17,440,104 €

Tabela 2. Struktura e shpenzimeve sipas fushave prioritare dhe burimit të financimit

Fusha	Shpenzime gjithsej		
	BRK	Donatorët	Gjithsej:
Punësimi	1,283,600 €	13,830,000 €	15,113,600 €
Arsimi dhe Aftësimi	1,010,480 €	1,316,024 €	2,326,504 €
Gjithsej:	2,294,080 €	15,146,024 €	17,440,104 €

Procesi i hartimit të Planit të Veprimit për Rritjen e Punësimit të Rinjve është udhëhequr nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Duke pasur parasysh që ky Plan ka karakter ndërsektorial, për hartimin e këtij Plani në prill të vitit 2017 është themeluar grupi ndërministror, i përbërë nga përfaqësuesit e ministrive që ndërlidhen me punësim, arsimin dhe trajnimin. Grupi është përbërë nga përfaqësuesit e ministrive në vijim: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Financave (MF), Ministria e Integritimit Evropian (MIE) dhe Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS) të Zyrës së Kryeministrit.

Procesi i zhvillimit të Planit të Veprimit, ka filluar në fillim të muajit prill 2017 dhe ka përfunduar në fund të nëntorit të vitit 2017, dhe i gjithë procesi i hartimit është mbështetur nga konsulentët e angazhuar

nga GIZ. Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit është një kombinim i punëtorive dhe takimeve individuale me aktorët kyç vendor dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë përfaqësuesit e bizneseve. Pas analizës së shkurtër të gjendjes në tregun e punës dhe arsimit, janë përcaktuar objektivat specifike, aktivitetet dhe veprimet konkrete, të cilat janë buxhetuar. Plani i Veprimit në aspektin strukturor është hartuar në përputhje me udhëzimin administrativ të Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS) dhe nën udhëzimet e vazhdueshme të kësaj zyre, përmes përfaqësuesit të kësaj zyreje në grupin punues.

Falënderime

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale shpreh mirënjohje për kontributin e Grupit punues, për GIZ për mbështetjen e ofruar në hartimin e këtij plani, për ekspertët e angazhuar; për mbështetjen e partnerëve zhvillimor, si dhe të shumë palëve të tjera që i kushtuan kohë dhe energji zhvillimit të planit.

2. Sfondi


Sipas vlerësimit të popullsisë, nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2016, numri i të rinjve në Kosovë ishte 344,961, që përbën pothuajse një të pestën e popullsisë, dhe rreth 30 përqind të popullsisë në moshë pune. Kjo pjesëmarrje e lartë e të rinjve, cilësohet si një ndër përparësitë kryesore për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit, por që mbetet ende një potencial i pashfrytëzuar.

Gjatë periudhës 2012-2016, norma e papunësisë tek të rinjtë ka qenë dukshëm më e lartë se ajo e popullsisë në moshë pune (Figura 1). Përkundër, trendit të rënies së papunësisë përgjatë periudhës 2012-2016, në vitin 2016, norma e papunësisë tek të rinjtë ishte 52.4%, normë kjo dy herë më e lartë se norma e përgjithshme e papunësisë në vend (27.5%) dhe shumë më e lartë se ajo e të rinjve në Bashkimin Evropian, prej 20.4 përqind sa ishte në vitin 2015¹. Është me rëndësi të theksohet se në mesin e të rinjëve, norma e papunësisë te vajzat është dukshëm më e lartë sesa te meshkujt, 65.4% dhe 47.2% respektivisht.

Sipas të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP-së) në vitin 2016, shkalla e punësimit të të rinjve ishte vetëm 10.1%, dukshëm më e vogël se norma e përgjithshme e punësimit në vend, prej 28.0%. Ekzistojnë dallime të dukshme gjinore edhe tek ky tregues i tregut të punës: në vitin 2016, vetëm 4.4% të vajzave të moshës 15-24 vjeçare ishin të punësuar në krahasim me 15.2% të djemve të kësaj grup moshe.

Statistikë tjetër shqetësuese, është fakti se në vitin 2016, 103,800 persona-afër një e treta e të rinjve (26.5% e djemve dhe 34.2% tek vajzat) nuk ishin as të punësuar, as në arsim dhe as në trajnim, në krahasim me 10.2%² sa ishte në Bashkimin Evropian. Kjo nënkupton se të rinjtë në Kosovë, përveç që nuk janë duke punuar, ata nuk janë duke i zhvilluar shkathtësitë e tyre, që do të ndihmonte punësimin e tyre, në të ardhmen.

Figura 1. Shkalla e papunësisë dhe punësimit të të rinjtë në Kosovë, 2012-2016 (në %)



Burimi: ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore 2012-2016

Përveç shkallës së ulët të punësimit, të rinjtë në Kosovë poashtu kanë më shumë gjasa për të punuar pa kontrata pune. Përgjatë viteve 2012-2016, në mesatare, afër gjysma e të rinjve të punësuar, nuk kanë pasur kontrata pune ndërsa në vitin 2016 kjo shifër ka arritur në 54.8%. Kjo nënkupton se të rinjtë nuk kanë pasur mundësi t'i gëzojnë të drejtat e garantuara të punëtorëve dhe nuk kanë kontribuar në fondin e

¹ Eurostat, Key figures on Europe 2016 edition: <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/3217494/7827738/KS-EI-16-001-EN-N.pdf/bbb5af7e-2b21-45d6-8358-9e130c8668ab>

² Eurostat, të dhënat për vitin 2015: <http://ec.europa.eu/eurostat/ceb/youth/statistics-illustrated>

tyre të pensionit, si burim i të ardhurave për të ardhmen. Të rinjtë në Kosovë, janë në pozitë të pafavorshme edhe sa i përket pagës minimale. Aktualisht, paga minimale për të rinjtë është 130 EUR, në krahasim me pagën minimale standarde prej 170 EUR, e që i bie të jetë më e ulët për 24%. Këto të dhëna, udhëzojnë, që krahas përmirësimit të normës së punësimit për të rinjtë, duhet ndërmarrë masa edhe për përmirësimin e cilësisë së punësimit të tyre.

Tabela 3: Treguesit e tregut të punës, tek të rinjtë

	2012	2013	2014	2015	2016
Përqindja e të rinjve në numrin e përgjithshëm të të papunëve (%)	32.0	31.0	28.5	27.4	30.4
NEET (%)	35.1	35.3	30.3	31.4	30.1
Të rinjtë e punësuar pa kontratë pune	37.8	41.0	38.5	38.5	54.8

Burimi: ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore 2012-2016

Strategjia Sektoriale për Punësim dhe Mirëqenie Sociale thekson se faktorët kryesorë për shkallën e ulët të punësimit të të rinjtë janë: orientimi i të rinjve në programe shkollimi që nuk kërkohen nga tregu i punës; mungesa e ndërlikdhjes së programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës; mungesa e punës praktike në shkollë dhe praktikës profesionale në ndërmarrje (që është posaçërisht e rëndësishme në rastin e arsimit profesional); mungesa e këshillimit dhe orientimit në karrierë; si dhe mungesa e përvojës së punës dhe kontakteve (rrjetëzimit) me punëdhënës potencialë. Mungesa e aftësive, përvojës së punës dhe fondeve janë pengesa kryesore për krijimin e bizneseve të reja nga të rinjtë. Strategjia Sektoriale për Punësim dhe Mirëqenie Sociale 2018-2022, përfshin aktivitete specifike për luftimin e punësimit joformal, ndërsa qeveria ka jap zotime për unifikimin e pagës minimale.

Është me rëndësi të theksohet, se në mesatare, përgjatë periudhës 2012-2016, të rinjtë e papunë përbënin afër një të tretën e numrit të përgjithshëm të të papunëve në Kosovë. Kjo do të thotë, se rritja e punësimit të të rinjtë, do të reflektojë në përmirësimin e rëndësishëm të treguesve të tregut të punës në Kosovë. Tabela 4 tregon që sa më i lartë të jetë shkollimi aq më e lartë do të jetë mundësia për punësim (57.1%).

Tabela 4: Punësimi sipas nivelit arsimor

Kosovë	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Punësimi (në mijëra)			
Pa shkollë	0.8	0.4	0.3
Fillor	60	14.1	45.9
Arsimi i mesëm profesional	112.5	19.3	93.3
Shkolla e mesme - gjimnazi	73.1	11.2	61.8
Arsimi i lartë	85.4	29.3	56.1
Gjithsej	331.8	74.4	257.4
Shkolla e punësimit (%)			
Pa shkollë	2.6	2	4.3
Fillor	13.6	5	28.5
Arsimi i mesëm profesional	36.2	17.3	46.9
Shkolla e mesme - gjimnazi	29.1	10.4	43.1
Arsimi i lartë	57.1	46.5	64.9
Gjithsej	28	12.7	43

Burimi: ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore 2016

Shkalla e papunësisë është më e larta për personat e pashkolluar (47.2% e këtij grupi ishin të papunë) dhe më e ultë për personat që kishin përfunduar arsimin e lartë (18.0%) (Tabela 5). Shkollimi ka përmirësuar

perspektivat në tregun e punës, në veçanti për meshkuj pasi 62.9% e meshkujve të pashkolluar ishin të papunë, në krahasim me 11.6% të atyre që kishin përfunduar arsimin e lartë (Tabela 5).

Tabela 5. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Punësimi (në mijëra)			
Pa shkollë	0.7	0.1	0.6
Fillor	29.0	4.7	24.2
Arsimi i mesëm profesional	54.2	12.2	42.0
Shkolla e mesme - gjimnazi	23.4	6.2	17.2
Arsimi i lartë	18.8	11.4	7.4
Gjithsej	126.1	34.7	91.4
Shkolla e punësimit (%)			
Pa shkollë	47.2	19.5	62.9
Fillor	32.6	25.2	34.5
Arsimi i mesëm profesional	32.5	38.8	31.1
Shkolla e mesme - gjimnazi	24.3	35.7	21.7
Arsimi i lartë	18.0	28.0	11.6
Gjithsej	27.5	31.8	26.2

Burimi: ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore 2016

Arsimi dhe aftësimi profesional është njëri nga nën sektorët më të rëndësishëm i cili përgatitë individët për punë, përkatësisht i pajisë ata me shkathtësi, njohuri dhe kompetenca të nevojshme për tregun e punës. Cilësia e arsimit dhe aftësimin profesional, si dhe harmonizimi i kërkesave të sistemit arsimor me tregun e punës, ndikojnë në mundësitë për punësim, ngritjen profesionale të individëve, mirëqenien sociale dhe në zhvillimin ekonomik të vendit, përkatësisht, në rritjen e vetëpunësimit dhe të punësueshmërisë.

Sipas statistikave të arsimit në Kosovë 2015/2016, 42,600 nxënës vijnë në arsimin e mesëm të lartë (arsimin profesional) në shkollat profesionale, prej të cilëve 25,877 (60.7%) meshkuj dhe 16,723 femra (39,3%). Sfidat kryesore të cilat e karakterizojnë sektorin e arsimit profesional në Kosovë janë mospërshtatja e programeve të AAP-së me kërkesat e tregut të punës, numri i kufizuar i standardeve të profesionit, rishikimi dhe zhvillimi i kurrikulave sipas standardeve të profesionit, trajnimi i mësimit dhe instruktorëve, pajisja e punëtorëve, materialet mësimore dhe mbështetëse, dhe realizimi i praktikës profesionale. Shkollat profesionale kanë mungesë të bashkëpunimit me sektorin e biznesit, në ofrimin e përgatitjes adekuate profesionale dhe realizim të punës praktike të kandidatëve gjatë aftësimin profesional. Praktikatat profesionale të cilësisë së lartë do të rrisin mundësitë e kandidatëve për vetëpunësim, punësim, por edhe mundësitë për punësim në ato ndërmarrje ku përfundojnë praktikën. Këshillimi dhe orientimi në karrierë është një shërbim tjetër që mungon në shkollat profesionale dhe që është i domosdoshëm për një sistem funksional të AAP-së në vend. Ky shërbim, përmes këshilltarëve të karrierës, do të duhej të sigurohej për të gjitha shkollat e AAP-së.

Mospërputhja e nevojave të tregut të punës me njohuritë e fituara në arsimin e lartë është identifikuar si një prej pengesave kryesore për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Komuniteti afarist ankohet se fuqia punëtore ka shkathtësi të mangëta dhe të papërputhshme me nevojat e tyre. Nga ana tjetër, bashkëpunimi i institucioneve të arsimit të lartë me komunitetin afarist është shumë i ulët, ndërsa, institucionet e arsimit të lartë kanë shërbime joefikase dhe ende të pazhvilluara për orientim dhe këshillim në karrierë të studentëve. Kështu, sfida mbetet rishikimi i programeve të studimit për të reflektuar nevojat

e tregut të punës dhe orientimi i studentëve kah studimi i fushave deficitare dhe strategjike për zhvillimin e vendit më qëllim të përmirësimit të punësueshmërisë.

3. Përmbledhje e dokumenteve relevante strategjike

Tabela në vijim, pasqyron fushat e përfshira në dokumentet strategjike, që kontribuojnë në arsimin, trajnimin dhe punësimin e të rinjve.

Tabela 6: Dokumentet strategjike

Dokumenti strategjik	Institucioni bartës	Fushat e përfshira
Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (NDS)	Zyra e Kryeministrit	Ndërlidhja e arsimit dhe trajnimeve me kërkesën e tregut të punës. Luftimi i ekonomisë jo-formale.
Strategjia Sektoriale (Draft) 2018-2022	MPMS	Ofrimi i shërbimeve cilësore të punësimit. Rritja e mbulueshmërisë dhe efikasitetit të masave aktive të tregut të punës, në harmoni me kërkesën e tregut të punës. Luftimi i punësimit jo-formal.
Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017	MTI	Përkrahja e vazhdueshme e zhvillimit të aftësive teknike, inovative dhe menaxheriale, për ndërmarrësit e rinj dhe ekzistues. Përmirësimi i vazhdueshëm i qasjes në financa, duke përfshirë edhe ofrimin e granteve për ndërmarrësi.
Strategjia e Kosovës për Teknologji Informative	MZHE	Ngritja e ndërmarrësisë në fushën e IT-së, duke përfshirë, promovimin e një ekosistemi dhe kornizës së kushteve nxitëse ndaj ndërmarrësisë në TI. (masat kryesisht për rritjen e informimit, dhe bashkepunimin e ndërmarrjeve të reja me ato ekzistuese).
Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021	MASHT	Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës në vend.
Strategjia e Praktikës Profesionale 2013-202	MASHT	Propozon disa intervenime për t'i motivuar punëdhënësit që të angazhojnë nxënësit dhe mekanizma për të siguruar që nxënësit kanë praktikë të cilësisë profesionale.

4. Akterët kryesorë në fushën e arsimit, trajnimit dhe punësimit

Për të rritur punësimin, qeveria, përmes minsitrive dhe agjencive të ndryshme, ofron programe dhe shërbime të ndryshme mbështetëse. Për të përfutur, pothuajse në të gjitha masat e ofruara, të rinjtë konsiderohen si grup me përparësi për përfitim. Tabela 7, ofron një përshkrim të shkurtër të masave dhe shërbimeve të ofruara, sipas secilit institucion qeveritar.

Tabela 7: Masat dhe shërbimet e institucioneve qeveritare, relevante për rritjen e punësimit të të rinjve

Institucioni	Masat
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) Agjencia e Punësimit	Shërbimet e punësimit, përmes Zyrave Lokale të Punësimit Masat Aktive të Tregut të Punës, duke përfshirë edhe aftësimin profesional (të ofruar në 7 Qendrat e Aftësimit Profesional) Praktikë në punë (internship për të sapo diplomuarit nga arsimi i lartë)
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)	Trajnime për ndërmarrësi Grante për ndërmarrësi Internship për të sapo diplomuarit nga arsimi i lartë
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	Grante Subvencione Trajnime Shërbime të këshillimit
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të MBPZHR Agjencia për Barazi Gjinore	Agjenci ekzekutive e cila merret me implementimin e programeve për mbështetje në bujqësi dhe zhvillim rural. Harton, zbaton, koordinon dhe monitoron politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë. Subvencione për ndërmarrësi
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)	Trajnime
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Trajnime
Minsitria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Arsim, Shërbime të Orientimit dhe Këshillimit të Karrierës
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	Validim të standareve të profesionit
Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, në kuadër të MASHT	Arsim profesional, Shërbime të Orientimit dhe Këshillimit të Karrierës

5. Objektivat e Planit të Veprimit

Qëllimi kryesor i intervenimeve të këtij Plani të Veprimit është Rritja e punësimit dhe përmirësimi i punësueshmërisë për të rinjtë.

Realizimi i këtij Objektivi do të arrihet përmes objektivave specifike në vijim:

Objektivi specifik 1: Rritja e qasjes së të rinjve në tregun e punës, përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit dhe masave aktive të punësimit

Objektivi specifik 2: Rritja e punësimit përmes zhvillimit të ndërmarrësisë

Objektivi specifik 3: Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës dhe ofrimi i shërbimit të orientimit dhe këshillimit në karrierë

Objektivi specifik 4: Ngritja e cilësisë së mësimin praktik në shkollë dhe praktikës profesionale jashtë shkollës

6. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit

Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të Rinjve në aneksin e saj është i plotësuar me planin e veprimit që mbulon periudhën 2018-2020. Plani i veprimit i përfshinë të gjitha të dhënat relevante si aktivitetet, treguesit, institucionet përgjegjëse për zbatim dhe buxhetin e nevojshëm për zbatim. Gjatë zbatimit të aktiviteteve të këtij plani, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet aplikimit të qasjeve që mundësojnë dhe garantojnë përfituesit nga radhët e grupeve të marginalizuara në shoqëri (komuniteteve etnike pakicë, grave dhe personave me nevoja të veçanta/aftësi dhe grupe të tjera).

Zbatimi i këtij plani të veprimit do të vlerësohet dy herë gjatë periudhës së vlefshmërisë së planit në bazë të treguesve të cilët janë të vendosur në nivel të objektivave specifike. Vlerësimi i parë afat-mesëm i zbatimit të Planit duhet të realizohet në mes të vitit 2019, ndërsa vlerësimi përfundimtar në vitin 2020. Objektivat specifike në disa raste përmbajnë më shumë se një tregues, të cilët janë të shumtën e rasteve tregues numerik, por ka edhe të tillë që janë cilësor. Treguesit janë vendosur si caqe afashkurta dhe afatmesme, ndërkohë që për secilin tregues është vendosur edhe baza fillestare.

Monitorimi i zbatimit të Planit të veprimit duhet të ndihmon që të përmirësohet ekzekutimi i aktiviteteve të parashikuara në plan dhe të arrihen rezultatet e pritshme. Objektivat kryesore të këtij procesi duhet të jenë:

- Monitorimi i zbatimit të aktiviteteve të Planit;
- Monitorimi i realizimit të objektivave të Planit;
- Mundësimi i korrigjimit dinamik të procesit në bazë të rekomandimeve të nxjerra nga informatat e fituara nga procesi i monitorimit.

Monitorimi i progresit të zbatimit dhe arritjet e strategjisë, do t'i komunikohen instancave përkatëse në baza të rregullta dhe sipas nevojës edhe opinionit publik. Për monitorimin e zbatimit të këtij plani do të jetë përgjegjës Grupi Drejtues Ndërministror i udhëhequr nga MPMS. Grupi do të koordinohet teknikisht nga Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së dhe do t'i ketë në përbërje drejtorët e departamenteve përkatëse në MPMS, ministritë e tjera, përfaqësues të mekanizmave gjinorë, përfaqësues të komuniteteve pakicë, përfaqësues të sektorit privat apo shoqatave të ndryshme të bizneseve sipas sektorëve prioritarë. Detyra kryesore e këtij grupi është që të kryejë shqyrtimin afatmesëm të zbatimit të strategjisë dhe shqyrtimin afatgjatë (përfundimtar), si dhe t'i ofrojë përgjigje Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës mbi zbatimin e strategjisë.

7. Plani i Veprimit dhe buxheti

Objektivi specifik 1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2019	Caku 2020
Rritja e qasjes së të rinjëve, në tregun e punës, përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit (këshillime, orientimi në karrierë, programe të praktikës, ndërmjetësimi i punësimit në vend dhe jashtë vendit, etj.) dhe masave aktive të punësimit	<ul style="list-style-type: none"> Norma e punësimit Përqindja e të rinjëve as të punësuar, as në arsim e as në trajnim (NEET) 			<ul style="list-style-type: none"> 10.1%³ (F: 4.4%; M: 15.2%) 30.1%⁴ (F: 34.2%; M: 26.5%) 	<ul style="list-style-type: none"> 13% (F: 8%; M: 17%) 24% (F: 28%; M: 24%) 	<ul style="list-style-type: none"> 15% (F: 13%; M: 18%) 20% (F: 24%; M: 20%)
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1.1. Realizimi i një studimi, për identifikimin e sektorëve (në nivel lokal) me potencial për punësimin e të rinjve (duke pasur në konsideratë gjininë, etninë dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara)	TM1 2018	4,000 EUR	Donatorët	DPP/MPMS	MTI; MBPZHR; MIN; Odat Ekonomike dhe shoqatat e bizneseve; Grupet Lokale të Veprimit	Analiza e publikuar
1.2. Dizajnimi dhe ofrimi i shërbimeve të reja të punësimit, dhe në forma të reja, adekuate për të rinjtë	TM3 2018	16,000 EUR	Donatorët	DPP/MPMS APRK	Këshillat dhe Qendrat	Analiza e finalizuar, shërbimet e reja të dizajnuara,

³ ASK, 2017, Anketa e Fuqisë Punëtore 2016: <http://ask.rks-gov.net/media/3229/afp-2016.pdf>

⁴ ASK, 2017, Anketa e Fuqisë Punëtore 2016: <http://ask.rks-gov.net/media/3229/afp-2016.pdf>

<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve, të ofruara nga vendet e zhvilluara, specifikisht për të rinjtë - Dizajnimi i shërbimeve të reja, për të rinjtë dhe ofrimi i shërbimeve në formë të përshtatshme për shfrytëzuesit e moshës së re 					Rinore	këshilltarët e punësimit të trajnuar, dhe 200 të rinjë kanë pranuar shërbime të reja të punësimit
1.3. Ndërmjetësimi në punësim, përmes Zyreve të Punësimit	TM1 2018 - TM4 2020	Nuk ka kosto		APRK	Këshillat dhe Qendrat Rinore	3,000 të rinjë të punësuar 50% vajza 50% djem
<p>1.4. Zgjerimi i MATP, me efekt në punësimin e të rinjve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza e MATP, me efekt në punësimin e të rinjëve: Ky aktivitet është i parashikuar në Strategjinë Sektoriale, për TM1 2018, në analizë do të shtohet edhe grupmosha, për të analizuar efektin e MATP në punësimin e të rinjëve - Subvencionimi i pagave, për të rinjtë (APRK) - Trajnim në punë (APRK) - Praktikë në punë (APRK) - Ofrimi i MATP-ve të reja për të rinjë, bazuar në analizën e mësipërme, këtu përfshihet edhe dizajnimi i MATP-ve të reja (APRK) - Trajnimi në shkathtësi të buta (MKRS) 	TM1 2018 - TM4 2020	8,238,600 EUR	653,600 EUR Buxheti i Kosovës 7,585,000 EUR Donatorët	APRK DPP/MPMS MKRS KIESA	Odat ekonomike, shoqatat sektoriale, Këshillat dhe Qendrat rinore, Ofruesit privatë të trajnimeve	10,360 të rinjë do të marrin pjesë në masa aktive të tregut të punës 50% vajza 50% djem

<ul style="list-style-type: none"> - Trajnimi në punë (MKRS) të pakualifikuar, për të marrë shkathtësi në një profesion te ri - Praktika në punë për të sapo diplomuarit nga arsimi i lartë (KIESA) 						
1.5 Ofrimi i mundësive për migrim qarkor	TM1 2018	Nuk ka kosto shtesë (e planifikuar në Startegjinë Sektoriale të Punës dhe Mirëqenies Sociale)		APRK DPP		Sigurohet migrimi legal i të rinjve për punë në vendet e BE-së.
1.6 Rritja e numrit të të rinjve, pjesëmarrës në aftësim profesional dhe në trajnime <ul style="list-style-type: none"> - Ofrimi i trajnimeve në QAP-a - Blerja e shërbimeve të aftësimit profesional me ofrues të jashtëm, sipas kërkesë së të rinjëve dhe nëpërputhje me kërkesën e tregut të punës 	TM1 2018 - TM4 2020	600,000 EUR	50,000 EUR Buxheti i Kosovës 550,000 EUR Donatorët	APRK	Ofruesit privat të trajnimeve	10,000 të rinjë të trajnuar 50% vajza 50% djem
1.7 Njohja e praktikës në punë dhe punës vullnetare si përvojë pune (ndryshim/plotësim i Ligjit të Punës	TM1 2018	Nuk ka kosto		MPMS	Ministria e Financave	Ligji i Punës i ndryshuar, njohja e punës praktike

1.8 Mbështetja e nismave për punë vullnetare, me kontribut në punësimin e të rinjve	TM3 2018-TM 4 2020	60,000 EUR	5,000 EUR Buxheti i Kosovës 55,000 EUR Donatorët	MKRS	Këshillat dhe Qendrat Rinore	300 të rinjë të angazhuar në punë vullnetare, duke kontribuar në punësim
1.9 Promovimi i punës së QAP-ve dhe ZP-ve, duke adresuar përfshirjen e të rinjve, grave dhe ndarjen e profesioneve në baza gjinore	TM1 2018 - TM4 2020	Nuk ka kosto shtesë, ngase janë të planifikuar a në Startegjinë Sektoriale		APRK DPP/MPMS	Departmen- tet Komunale të Arsimit (DKA-të) Këshillat dhe Qendrat Rinore	Numër i rritur i të rinjëve që shfrytëzojnë QAP-at dhe ZP
1.10 Ofrimi i trajnimeve në fushën e TIK-ut (MZHE)	TM1 2018-TM 4 2020	975,000 EUR	Donatorët	MZHE	Këshillat dhe Qendrat Rinore Ofruesit privat të trajnimeve	900 të rinjë të trajnuar në fushën e TIK-ut 50% vajza 50% djem
Objektivi specifik 2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2019	Caku 2020
Rritja e punësimit përmes zhvillimit të ndërmarrësisë, tek të rinjtë dhe zhvillimi i ndërmarrjeve ekzistuese, në pronësi të të rinjve	• Numri i ndërmarrjeve në pronësi të të rinjve			Nuk ka të dhëna	540 ndërmarrje të reja	1,025 ndërmarrje të reja
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
2.1 Ofrimi i trajnimeve për ndërmarrësi - Ofrimi i trajnimit në QAP-at e EARK	TM1 2018-TM4 2020	260,000 EUR	135,000 EUR Buxheti i	APRK MKRS		1,600 të rinjë të trajnuar në

- Ofrimi i trajnimeve të mbështetura nga MKRS Ngritja e kapaciteteve të Qendrave Rinore në hartimin e projekt propozimeve, për ti trajnuar pastaj të rinjtë			Kosovës 125,000 EUR Donatorët			fushën e ndërmarrësisë 50% vajza 50% djem
2.2 Ofrimi i granteve për krijimin e ndërmarrjeve të reja (start-up)	TM1 2018-TM 2020	3,985,000 EUR	230,000 EUR Buxheti i Kosovës 3,755,000 EUR Donatorët	APRK MZHE MKRS KIESA MBPZHR	Agjencia për Mbështetje në Bujqësisë	795 të rinjë të vetëpunësuar 50% vajza 50% djem
2.3 Trajnime për fermerët e rinjë	TM1 2018-TM4 2020	75,000 EUR	10,000 EUR Buxheti i Kosovës 65,000 EUR Donatorët	MBPZHR Komunat	Ofruesit privat të trajnimeve	600 fermerë të rinjë të trajnuar 50% vajza 50% djem
2.4 Mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese - Grante - Shërbime këshilluese/Skema Voucher e KIESA-s	TM1 2018-TM4 2020	900,000 EUR	200,000 EUR Buxheti i Kosovës 700,000 EUR Donatorët	MZHE MBPZHR KIESA	Ofruesit privat të trajnimeve	100 të rinjë të punësuar 50% vajza 50% djem

Objektivi specifik 3	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Caku 2019	Caku 2020
Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës dhe ofrimi i shërbimit të orientimit dhe këshillimit në karrierë	<ul style="list-style-type: none"> Përqindja e profileve të arsimit profesional për të cilat ekzistojnë standarde të aprovuara të profesionit Numri i nxënësve që vijnë në arsimin e mesëm të lartë (arsimin profesional) në shkollat profesionale, prej të cilëve 25,877 (60.7%) meshkujt dhe 16,723 femra (39,3%). Indeksi i paritetit gjinor në drejtime teknike Rritja e numrit të nxënësve në drejtimet deficitare⁵ Numri i profileve të sistemit arsimor që janë azhurnuar sipas standardeve profesionale Shkalla e papunësisë për të rinjtë që kanë mbaruar arsimin profesional Përqindja e nxënësve që përfiton nga këshillimi në karrierë 	<p>Nga 140 profile në shkolla; prej tyre së paku 28 profesione i kanë standardet e aprovuara⁶; në AKK kanë dëshmi se 40 standarde janë të aprovuara⁷ (por prej tyre janë vetëm 28 të shkollave AAP)</p> <p>42,600 (25,877 - 60.7% M dhe 16,723 – 39.3% F).</p>	<p>15 profesione i kanë standardet e aprovuara</p> <p>Rritet 30% (20% për femra)</p>	<p>30 profesione i kanë standardet e aprovuara</p> <p>Rritet 30% (20% për femra)</p>
		0.25 ⁸		0.40
		37.8% ⁹		50%
		0%		50%
		32.5%		15%
		10% ¹⁰		30%/vit

⁵ Sipas Raportit të Vlerësimit të PSAK: Drejtimet deficitare janë: Shërbimet (personale, hotelieri, floktari, estetikë, transport, mbrojtje e natyrës, përkujdesje e kafshëve, sigurim i pronës, sigurim fizik, radiologji, anesteziologji, teknik i dhëmbëve, farmaci, fizioterapi, mami, rrobaqepësi) 9% nxënës : 27% vende pune; Bujqësi dhe veterinë 2.4% nxënës : 4% vende pune; Inxhinieri, përpunim, ndërtim 26.4% nxënës : 28% vende pune

⁶ Informatë nga Divizioni AAP, MASHT.

⁷ Informatë nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

⁸ Raport i një hulumtimi ende i pabotuar nga AAAPARR.

⁹ Burimi: Raport vlerësimi i PSAK 2011-2016 (fq: 53).

¹⁰ Bazuar në strategjinë për orientim dhe këshillim në karrierë.

Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
<p>3.1. Realizimi i studimeve sektoriale (tre-vjecare) të ndërlidhjes së programeve mësimore me kërkesat e tregut të punës</p> <p>- Angazhimi i ekspertëve për realizimin e studimit</p> <p>- Zhvillimi i kornizës që përcakton metodologjinë (standardin) për studimet sektoriale</p>	2018 - 2019	137,000 EUR	20,000 EUR Buxheti i Kosovës 117,000 EUR Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)	MPMS; Donatorët: GiZ (YES), ALLED (EU-ADA), EYE (HELVETAS), Banka Gjermane	Studimet e publikuara sektoriale (tre-vjecare) të ndërlidhjes së programeve mësimore me kërkesat e tregut të punës
<p>3.2. Rritja e bashkëpunimeve ndërmjet shkollave dhe bizneseve</p> <p>- Mbështetja e iniciativave të partneriteteve ndërmjet shkollave dhe bizneseve</p> <p>- Themelimi i këshillave koordinuese industrial në nivel komunal</p> <p>- Trajnimi i personelit të shkollave, të zyrave për bashkëpunim me ekonominë (Përgatitja e manualit trajnues dhe organizimi i trajnimit)</p>	2018 - 2019	320,700 EUR	303,500 EUR Buxheti i Kosovës 17,200 EUR Donatorët	MASHT Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)	Komunat AAAPARr Donatorët	Zbatimi i 30 partneriteteve ndërmjet shkollave dhe bizneseve Këshillat koordinues industrial janë funksional në të gjitha komunat në Kosovë Të gjithë anëtarët e zyrave për bashkëpunim me ekonominë të

						shkollave profesionale janë trajnuar
<p>3.3. Përmirësimi i sistemit të informatave të tregut të punës për të analizuar dhe përmirësuar mekanizmat për identifikimin dhe parashikimin e nevojave për shkathtësi dhe planifikim në sistemin e AAP-së</p> <p>- Përkrahje institucionale në shfrytëzimin dhe ndërlidhjen e të dhënave nga databazat e institucioneve përgjegjëse (SMIA, Regjistri civil, ASK, Shërbimet e punësimit, e tjera)</p> <p>- Krijimi i sistemit për analizën e tregut të punës në nivel nacional, rajonal dhe lokal (Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit Kombëtar të Parashikimit të Nevojave për Shkathtësi)</p> <p>- Zhvillimi i sistemit të gjurmimit (tracking system) për arsim dhe aftësim profesional</p>	2018 - 2019	270,200 EUR	63,200 EUR Buxheti i Kosovës 207,000 EUR Donatorët	MASHT Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)	AAAPARr Donatorët	Raportet e informatave të tregut të punës Sistemi Kombëtar për Parashikim të Nevojave për Shkathtësi është funksional
<p>3.4. Zhvillimi i standardeve të profesioneve të ofruara</p> <p>- Formimi i grupeve të ekspertëve për zhvillimin e standardeve të profesionit. Për 3 vite pritet të zhvillohen dhe validohen rreth 30 standarde</p> <p>- Verifikimi i standardeve</p>	2018 - 2019	153,000 EUR	Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT) Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	LuxDev, EU-ALLED	30 standarde të profesionit të validuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

- Rishikimi i standardeve të profesionit						
- Validimi i kualifikimeve						
<p>3.5. Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave bërthamë në një format modular, sipas sektorëve prioritar të AAP-së</p> <p>- Zhvillimi i Kurrikulës Bërthamë për AAP</p> <p>- Ofrimi i konsulencës profesionale për zhvillimin e kurrikulave modulare</p> <p>- Trajnim i mësimitdhënësve për zbatimin e kurrikulave modulare (3000 mësimitdhënës x 24 orë program trajnimi)</p> <p>- Përgatitja e materialeve mësimore (për profilet prioritare profesionale (Hartimi i materialeve për 7 fushat mësimore të përgjithshme të aplikuara në 17 sektorë profesionale)</p> <p>- Rishikimi i profileve që ofrohen në shkollat e AAP-së dhe përshtatja me nevojat e tregut (Formimi i grupit punues trepalësh i cili do ta bëjë analizën, harmonizimin e profileve me nevojat e tregut, dhe krijimin e listes me profilet prioritare që do të ofrohen)</p>	2018 - 2019	542,000 EUR	76,200 EUR Buxheti i Kosovës 465,800 EUR Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)	Donatorët	<p>Kurrikula bërthamë dhe kurrikulat modulare për lëndë janë zhvilluar dhe zbatohen</p> <p>Të gjithë mësimitdhënës it janë trajnuar për zbatimin e kurrikulave modulare të AAP-së</p> <p>Janë hartuar materialet për 7 fushat mësimore të përgjithshme të aplikuara në 17 sektorë profesional</p> <p>Profilet e ofruara në shkollat e AAP-së janë</p>

						rishikuar në përputhje me nevojat e tregut të punës
3.6. Krijimi i një strukture stimuluese (fondi të përbashkët) nga qeveria dhe bizneset, për mbështetjen e shkollimit në drejtimet deficitare dhe për femrat në drejtimet teknike - Ofrimi i bursave	2018 - 2019	60,000 EUR	Buxheti i Kosovës	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)		Nxënsësit në drejtimet deficitare dhe femrat në drejtimet teknike përfitojnë bursa për shkollim
3.7. Rritja e ofrimit të programeve të kualifikime të nivelit 5 - Identifikimi i nevojave për kualifikime të nivelit 5 - Zhvillimi i programeve të reja për arritjen e kualifikimeve në nivelin 5 post-sekondar sipas KKK-së	2018 - 2019	42,500 EUR	12,500 EUR Buxheti i Kosovës 30,000 EUR Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT) Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	Donatorët	Numër i rritur i studentëve në programet e nivelit 5 të kualifikimeve
3.8. Organizimi i fushatave vetëdijësuese dhe prezantimeve të rregullta në shkollat e AAP-së nga industria, për nxënësit e klasave 8 dhe 9 - Organizimi i fushatave vetëdijësuese	2018 - 2019	19,500 EUR	Buxheti i Kosovës	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)	Komunat	Realizimi i fushatave vetëdijësuese

<p>3.9. Rritja e numrit të Qendrave për Këshillim dhe Orientim në Karrierë dhe zbatimi i koncepteve sipas Kurrikulës Bërthamë</p> <p>- Caktimi i këshilltarëve të karrierës në shkolla</p> <p>- Trajnimi i mësimeve për këshillim dhe orientim në karrierë për të rinjtë</p>	2018 - 2019	145,512 EUR	144,000 EUR Buxheti i Kosovës 1,512 EUR Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)	Komunat Donatorët	30 shkolla kanë të angazhuar këshilltarët e karrierës 60 mësimeve janë trajnuar për këshillim dhe orientim karrierë të rinjëve
<p>3.10. Zhvillimi i mekanizmave për përcjelljen e të diplomuarve në shkollat e AAP dhe IAL</p>	TM 3-4 2018	31,000 EUR	Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)	Donatorët	Mekanizmat për përcjelljen e të diplomuarve në shkollat e AAP dhe IAL janë funksional
<p>3.11. Ofrimi i këshillimit dhe orientimit në karrierë</p> <p>- Ofrimi i trajnimit dhe pilotimi</p>	2018 - 2019			APRK	Realizohet në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për zbatimin e projektit “Këshillimi drejt punësimit dhe	Kapacitetet e ngritura të stafit për pilotim të qasjes së këshillimit drejt punësimit dhe vetëpunësimit

					sipërmarrjes” – Swisscontact	
Objektivi specifik 4.	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza		Caku 2019	Caku 2020	
Ngritja e cilësisë së mësimi praktik në shkollë dhe praktikës profesionale jashtë shkollës	• Mesatarja e numrit të përgjithshëm të orëve të mësimi praktik dhe të praktikës profesionale për nxënës ¹¹	Nuk ka të dhëna			170 orë/vit	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
4.1. Pajisja e punëtorive për praktikë bazë profesionale në shkollat e AAP - Themelimi i 15 punëtorive të shkollave të profileve të ndryshme (vetëm pajisjet) - Ndërtimi i hapësirave të reja - Renovimi i 5 hapësirave ekzistuese duke vendosur instalimin e nevojshëm (infrastruktura e rrymës, etj.)	2018 - 2019	508,500 EUR	238,500 Buxheti i Kosovës 270,000 EUR Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)	Donatorët	15 punëtori të shkollave profesionale janë funksionale Rritet/përmirësohet hapësira e shkollave profesionale
4.2. Nënshkrimi i marrëveshjeve me bizneset për praktikë profesionale me qëllim të ofrimit të mundësive për nxënësit për përmbushjen e praktikës së paraparë me planprogram	2018	2,000 EUR	Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)		Zbatimi i marrëveshjeve me bizneset për praktikë profesionale me qëllim të

¹¹ Shuma e numrit të nxënësve në programet e arsimit profesional shumëzuar me numrin e orëve praktike të realizuara gjatë një viti shkollor, pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në shkollat profesionale. Orët e mësimi praktik në shkollë¹¹/modulet profesionale: mesatarja 300 orë në vit. Jashtë shkolle: 40 orë praktike në vit për nxënës.

						ofrimit te mundësive për nxënësit për përmbushjen e praktikës së paraparë me planprogram
4.3. Zhvillimi i instrumenteve për stimulimin e kompanive për pranimin e nxënësve në praktikë - Ndërtimi i platformës së përbashkët mes palëve (shkollave, kompanive)	2018 - 2019	39,080 EUR	Buxheti i Kosovës 19,080 EUR Donatorët € 20,000	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)		Hartohet studimi i fizibilitetit për identifikimin dhe zhvillimin e instrumenteve për stimulimin e kompanive që ofrojnë praktikë profesionale për nxënësit e AAP-së, dhe trajnohen shkollat e AAP-së për instrumentet
4.4. Trajnimi i instruktorëve në ndërmarrje për mbështetjen e nxënësve në praktikë profesionale	2018 - 2019	1,512 EUR	Donatorët	Divizioni për arsim profesional dhe për të	Donatorët	Instruktorët në ndërmarrje kanë ndjekur me sukses

				rritur (MASHT)		programin e trajnimit
4.5. Zhvillimi i rregullores për mbrojtjen e shëndetit të nxënësve gjatë praktikës - Hartimi i rregullores - Pagesa e sigurimit shëndetësor për nxënësit	2018 - 2019	54,000 EUR	Buxheti i Kosovës	Divizioni për arsim profesional dhe për të rritur (MASHT)		Aprovohet rregullorja për mbrojtjen e shëndetit të nxënësve gjatë praktikës Ofrohet sigurimi shëndetësor për nxënësit gjatë praktikës profesionale